



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 19

27 shkurt

2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 6, datë 10.2.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve: nr. 7529, datë 22.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 979, datë 24.7.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-1237, datë 17.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	395
Vendim i GJK nr. 7, datë 10.2.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 424, datë 6.10.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	402

VENDIM
Nr. 6, datë 10.2.2014
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtar	e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 14.5.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 8, 10/1 Akti, që i përket:

KËRKUES: Myrteza Gjashta, Kimete Katroshi, Hasan Katroshi, Majlinda Katroshi, Fatjon Katroshi, Liljana Kraja, Sulejman Katroshi, Manjola Mako, Nadire Katroshi, Ikbale Katroshi, Violeta Katroshi, Mirela Katroshi, Etleva Katroshi, Laerta Demiri, Gazmir Demiri, Xhaferr Demiri, Florida Demiri, Foto Sava

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “Dinamo” sh.a., përfaqësuar nga av. Erinda Ballanca, me autorizim;

Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve: nr. 7529, datë 22.12.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 979, datë 24.7.2009 i Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-1237, datë 17.5.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 42/1, 42/2, 43, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27-30, 39, 42 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha; mori në shqyrtim pretendimet e paraqitura me shkrim nga kërkuesit dhe prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të Shaqir Katroshit dhe Hasan Katroshit. Në vitin 1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë, me vendimin nr. 145, datë 30.6.1995, ka vendosur: “1. Njohjen e pronësisë ish-pronarit Hasan Katroshi (trashëgimtarëve të tij) mbi 7.5 dynym tokë, sipas nenit 1 të ligjit nr. 7896, datë 15.4.1996, e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 313 dhe nr. 314, datë 24.4.1942. Prona, truell i lirë, me sipërfaqe 3 951 m², kthehet dhe kompensohet: (a) Parcela S1– 2 951 m², brenda territorit të Uzinës Dinamo (pas privatizimit); (b) Parcela S2 – 965 m², jashtë territorit të Uzinës Dinamo (menjëherë). 2. Njohjen e pronësisë mbi sipërfaqen 77 m², e zënë me ndërtime të përkohshme. (a) Trualli i zënë me ndërtime shtetërore, me sipërfaqe 298 m², 180 m², 52 m², 66 m², 574 m², i kompensohet sipas mënyrave të parashikuara nga ligji. (b) E drejta e privatizimit për sipërfaqet 180 m², 52 m², 66 m², sipas nenit 21 të ligjit”.

2. KKKP-ja Tiranë, me vendimin nr. 80, datë 5.11.1999, ka vendosur: “Të njohë ish-pronar Shaqir Katroshin (trashëgimtarët e tij, të paditurin Myrteza Gjashta) mbi pronën e tij të përbërë prej një toke me sipërfaqe 7500 m², të ndodhur në Hallias, dhe të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 889, datë 21.11.1939. (a) Prona, truell i lirë, me sipërfaqe 600 m² brenda ish-Uzinës Dajti, i njihet dhe i kthehet pronarit (kur ndërmarrjet të privatizohen). (b) Prona, truell i lirë, me sipërfaqe 4005 m² brenda ish-Uzinës Dinamo, i njihet dhe i kthehet pronarit (kur ndërmarrjet të privatizohen). (c) Trualli me sipërfaqe 2 895 m² (i zënë nga objektet e uzinës) t’i kompensohet sipas ligjit. (d) E drejta e parablerjes për objektet me sipërfaqe 322 m², 277.5 m², 60 m² kur uzina të privatizohet. (e) E drejta mbi sipërfaqen 1519 m² duhet t’i njihet gjyqësisht.”



3. Në vitin 2000, KKKP-ja Tiranë, me vendimin nr. 314, datë 16.9.2000, ka vendosur njohjen dhe kthimin e pronës ish-pronarit Shaqir Katroshti (trashëgimtarëve të tij, të paditurit Myrteza Gjashta) për sipërfaqen 1519 m², kur Uzina Dinamo të privatizohet, me kufizimet sipas vendimit të KKKP-së të vitit 1999, të njohur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2302, datë 7.7.2000. Vendimet e KKKP-së janë regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 81, datë 9.11.1999 dhe kërkuesi Myrteza Gjashta është pajisur me vërtetim pronësie.

4. **Shoqëria “Dinamo” sh.a.**, duke pretenduar se prona e saj mbivendosej me pronën që i ishte kthyer kërkuesit në sipërfaqen 2 896 m², i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt *“Anulimin e vendimeve nr. 145, datë 30.6.1995, nr. 80, datë 5.11.1999 dhe nr. 314, datë 16.9.2000, të KKKP-së Tiranë. Konstatimin nul të veprimeve juridike të kryera mbi bazën e tyre dhe regjistrimeve hipotekore, si absolutisht të pavlefshme dhe në kundërshtim me ligjin.”*

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7529, datë 22.12.2006, ka vendosur pranimin e padisë dhe anulimin e tri vendimeve të KKKP-së, konstatimin nul të veprimeve juridike të kryera mbi bazën e tyre, si dhe fshirjen nga regjistri hipotekor të shënimeve të bëra në favor të të paditurve, si në kundërshtim me ligjin.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 979, datë 24.7.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

7. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1237, datë 17.5.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit, në dhomë këshillimi, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

II

8. **Kërkuesi, Myrteza Gjashta**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin si të papajtuësëm me Kushtetutën të vendimeve: nr. 7529, datë 22.12.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 979, datë 24.7.2009 i Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-1237, datë 17.5.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi). Kurse **kërkuesit Kimete Katroshti, etj.**, i janë drejtuar kësaj Gjykate në një datë të mëvonshme, duke depozituar një kërkesë me të njëjtin objekt me atë të kërkuesit.

9. Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi bashkimin dhe shqyrtimin e kërkesave në një çështje të vetme, meqenëse kanë lidhje dhe objekti është i njëjtë.

10. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në aspektet e mëposhtme:

10.1 Legjitimimi i shoqërisë “Dinamo” sh.a., si palë paditëse, në proceset gjyqësore civile të zhvilluara në gjykatat e zakonshme, bie në kundërshtim me nenet 31 dhe 32 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pasi:

10.1.1 Trashëgimtarëve u është kthyer prona me vendimin nr. 145, datë 30.6.1995, kurse shoqëria “Dinamo” është krijuar dhe regjistruar si person juridik me vendimin nr. 12870, datë 24.11.1995.

10.1.2 Sipërfaqja prej 2 986 m² truell, pjesë e sipërfaqes së përgjithshme që u është kthyer trashëgimtarëve, nuk përfshihet në pasurinë e shoqërisë “Dinamo” sh.a., pasi me vendimin gjyqësor nr. 6964, datë 14.8.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zvogëlimin e kapitalit, sipërfaqja e mësipërme nuk është përfshirë në procesin e privatizimit. Ky fakt provohet edhe nga kontrata e shitblerjes nr. 3475, datë 19.11.1999, e cila ka për objekt shitjen e sipërfaqes prej 43 958 m², dhe jo prej 46 218 m².

10.2 Çështja është zgjidhur nga gjykatat e zakonshme në kundërshtim me nenet 6, 10, 14, 16, 20, 28, 29 të KPC-së, pa zhvilluar një hetim gjyqësor të plotë, pa marrë në konsideratë provat e administruara, pa thirrur ekspertë të tjerë, por duke pranuar vetëm njërin nga tri aktet e ekspertimit me konkluzione të ndryshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka interpretuar gabim ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993, duke arritur në përfundimin, gjithashtu të gabuar, se kërkuesit nuk janë subjekte përfituese të

këtij ligji, pasi nuk disponojnë vendim shpronësimi dhe se trashëgimlënësit e tyre e kanë shitur pronën përpara vitit 1943. Kurse Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka respektuar kërkesat e nenit 224/c të KPC-së, duke thirrur të njëjtin ekspert që kishte dhënë mendim gjatë gjykimit në shkallë të parë. Edhe pse është kërkuar përjashtimi i tij, gjykata nuk u shpreh në lidhje me këtë kërkesë. Po ashtu, Gjykata e Apelit nuk pasqyron në vendim shkaqet e ankimit dhe as u jep përgjigje pretendimeve në lidhje me efektet e ligjit nr. 61/1945, që lë pa fuqi juridike të gjitha dekretet, ligjet, vendimet dhe rregulloret e miratuara nga qeveria e kohës së okupacionit.

10.3 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike dhe i pritshmërive të ligjshme*, pasi gjykatat nuk kanë zbatuar me analogji vendimin unifikues nr. 25, datë 28.3.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, edhe pse çështja civile ka ngjashmëri, nga pikëpamja e fakteve, rrethanave, shkakut juridik, statusit juridik të paditësit (shoqëri tregtare për shkak privatizimi), të paditurit (KKKP-ja), objektit (anulimi i vendimeve të KKKP-së) dhe bazës ligjore, me çështjen për të cilën është marrë vendimi unifikues. Duke mos respektuar fuqinë juridike të vendimit unifikues për sipërfaqen 600 m² truall, e trajtuar si e tërë me vendimet e KKKP-së, në favor të kërkuarit, por që gjendet brenda territorit të ish-Uzinës Dajti, dhe duke anuluar në tërësi vendimet e KKKP-ve, gjykatat janë shprehur jashtë objektit të padisë, në kundërshtim me nenet 6, 10, 16 dhe 28 të KPC-së.

10.4 Po ashtu, është cenuar *parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi për të njëjtat fakte, rrethana, objekt dhe shkak juridik, gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në zgjidhjen e çështjeve civile të ngjashme. Edhe pse konflikti me shoqërinë “Dinamo” sh.a. ndodhet në të njëjtat kushte objektive me konfliktin e lindur ndërmjet pronarëve të familjeve Metani, Daja, Maçi, Fortuzi etj., me shoqërinë “Dajti” sh.a., konflikt që ka marrë zgjidhje me vendimin unifikues nr. 25, datë 28.3.2003, ky i fundit është zbatuar në mënyra të ndryshme.

10.5 Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar nenin 349 të KPC-së, dhe, po ashtu, ka cenuar të drejtën e ankimit efektiv, të drejtën për t’u mbrojtur e për t’u dëgjuar dhe standardin kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi pretendimet e parashtruara në rekurs, të cilat kishin të bënin me cenimin e standardeve kushtetuese të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të kishin marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë.

11. **Subjekti i interesuar, Shoqëria “Dinamo” sh.a.**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

11.1 Sipërfaqja prej 46 218 m² është kapitalizuar si aset i shoqërisë “Dinamo”, duke u regjistruar në ZRPP me nr. 92, datë 22.4.2004, zona kadastrale 8340. Duke qenë se sipërfaqja e truallit objekt përkon me vlerën e 33 % të paketës së aksioneve të shtetit, shoqëria “Dinamo” sh.a. legjitimohej të kërkonte pavlefshmërinë e vendimeve të KKKP-ve.

11.2 Pretendimi i kërkuarve për zbatimin e gabuar të ligjit material dhe cenimin e neneve 31 dhe 32 të KPC-së është abuziv dhe i pabazuar, pasi trashëgimlënësit e kërkuarve e kanë humbur pronësinë mbi pronën objekt shqyrtimi përmes kontratës së shitjes nr. 22875/12152, datë 5.1.1943, dhe regjistrimit në emër të shtetit në regjistrin nr. 88, datë 30.1.1943.

11.3 Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi për moskryerjen e një hetimi të plotë mbi çështjen, në kundërshtim me nenet 14 dhe 28 të KPC-së, ose për caktimin e ekspertit topografik. Gjykata e apelit ka vepruar në përputhje me nenet 225 dhe 229 të KPC-së, duke thirrur të njëjtin ekspert topograf që ka kryer ekspertimin gjatë gjykimit në shkallë të parë, jo me cilësinë e ekspertit të ri, por për të dhënë shpjegime mbi ekspertimin topografik.

11.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi kjo e fundit nuk nënkupton fitimin e pronësisë mbi një pronë pa një titull të ligjshëm. Po ashtu, nuk ndodhemi përpara ndryshimeve apo paqëndrueshmërisë së ligjit apo të praktikës gjyqësore, çka do të sillte pasoja negative për individin.

11.5 Lidhur me pretendimin se nuk është marrë në konsideratë vendimi unifikues nr. 25, datë 28.3.2003 i Gjykatës së Lartë, ky pretendim prapësohet, pasi nuk ekzistojnë të njëjtat rrethana dhe kushte, veçanërisht përsa i përket shpronësimit, lidhjes së kontratës së shitjes, pagesës dhe kalimit të pronës në favor të shtetit. Ky i fundit, në ndryshim nga rasti i shoqërisë “Dajti”, nuk e ka transferuar paketën prej 33 % të aksioneve që përfaqëson vlerën e truallit të familjes Katroshi, duke mos u njohur trashëgimtarëve statusin e aksionerëve në shoqërinë “Dinamo” sh.a.



11.6 Edhe pretendimi për cenimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në Gjykatën e Lartë është i pabazuar, pasi vendimi i mospranimit të rekursit në dhomë këshillimi merret pa praninë e palëve.

12. **Subjekti i interesuar, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, ka prapësuar se kërkesa është e pambështetur në ligj dhe prova dhe, si e tillë, duhet rrëzuar. AKKP-ja parashtron, në mënyrë të përmbledhur, se:

12.1. Vendimi nr. 80 i KPPP-së Tiranë është i drejtë, pasi neni 19 i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, parashikonte kalimin e pronësisë në momentin e privatizimit të Uzinës Dinamo, e cila ka pronar të vetëm shtetin, të përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE).

12.2 Vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi janë të drejta dhe të dhëna në zbatim të ligjit dhe të provave. Kërkesit nuk kanë paraqitur asnjë fakt ose rrethanë për të vërtetuar shkeljet materiale dhe procedurale gjatë shqyrtimit të çështjes.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

13. Gjykata, paraprakisht, thekson se ajo i vlerëson pretendimet e kërkesve në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor, dhe, konkretisht, në aspektin e detyrimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për respektimin e këtyre standardeve.

A. Mbi pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme dhe barazisë para ligjit

14. Kërkesit pretendojnë se gjykatat e zakonshme, duke mos respektuar vendimin unifikues nr. 25, datë 28.3.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, të pritshmërive të ligjshme dhe atë të barazisë përpara ligjit.

15. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnjë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera, ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme. Në ushtrimin e veprimtarisë së tyre gjyqësore gjykatat, në funksion të fakteve dhe çështjes konkrete, përcaktojnë nëse çështja që duhet të zgjidhin është e ngjashme me çështje të zgjidhura më parë nga Gjykata e Lartë nëpërmjet një vendimi unifikues (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata konstaton se vendimi unifikues nr. 25, datë 28.3.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është marrë në përfundim të një procesi gjyqësor, i cili e ka zanafillën në kërkesëpadinë e paraqitur nga shoqëria “Dajti” sh.a., në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “*Kundërshtimin e vendimit të KKKP-së dhe pushimin e të drejtave mbi aksionet e të paditurve në “Dajti” sh.a., dhe fshirja e tyre nga lista e aksionarëve të paditësit*”. Të paditurit (ish-pronarët) në këtë proces gjyqësor ishin aksionarë që zotëronin 21.48% të aksioneve. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar praktikën me vendimin unifikues në fjalë dhe kanë arritur në përfundimin se: “...*paditësi, subjekt i të drejtës tregtare, që është bërë pronar pas privatizimit, nuk legjitimohet të ngrrejë padi për shfuqizimin e vendimeve të KKKP-ve, kur pjesa e truallit që iu është njohur ish-pronarëve (trashëgimtarëve të tyre) është përfshirë në kapitalin e shoqërisë aksionare*”.

17. Nisur nga qëndrimi i Gjykatës së Lartë dhe bazuar në natyrën e pretendimeve të kërkesve, Gjykata vëren se argumentet e parashtruara nga kërkesit kanë të bëjnë me verifikimin e interpretimit të rrethanave dhe fakteve nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm gjatë proceseve gjyqësore civile me paditës shoqërinë tregtare “Dajti” sh.a. dhe “Dinamo” sh.a. Nisur nga këto konstatime, Gjykata vlerëson se gjykimi kushtetues nuk ka për qëllim të rivlerësojë faktet dhe rrethanat e një çështjeje konkrete, por të analizojë ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja “f” e Kushtetutës, gjë që përbën juridiksionin e saj kushtetues, thelbësisht të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

18. Për arsyet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuessve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme dhe barazisë para ligjit janë të pabazuara.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së ankimit efektiv, të së drejtës për t'u dëgjuar dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë

19. Sipas kërkuessve, Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, ka cenuar të drejtën e ankimit efektiv, të drejtën për t'u dëgjuar, si dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Edhe pse kërkuessit parashtronin në rekurs shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pa u shprehur për shkaqet konkrete të mospranimit.

20. Neni 43 i Kushtetutës parashikon se “*kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*”. Në jurisprudencën e kësaj Gjykate, e drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individi) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 5, datë 2.3.2010; nr. 12, datë 14.4.2010; nr. 14, datë 26.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit, ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale, është pjesë e të drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'u drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009, dhe nr. 7, datë 11.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa i përket rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 480 i KPC-së parashikon se Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraeliminatory të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund t'ia deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivist nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Megjithatë, nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit civil, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit Civil për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 22, datë 6.6.2011*).

23. Vendimi i dhënë në dhomën e këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi Kolegji i Gjykatës së Lartë ka vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Civile, dhe nuk ka marrë attribute që i takojnë seancës gjyqësore. Nga ana tjetër, edhe arsytimi i këtij vendimi nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë negativisht në këtë drejtim. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



24. Nga rrethanat e çështjes konkrete rezultojnë se kërkesit kanë paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, që la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-11237, datë 17.5.2012, vendosi mospranimin e rekursit, në dhomë këshillimi.

25. Në këtë kuptim, bazuar në standardet kushtetuese mbi të drejtën e ankimit efektiv, karakteristikat e procesit të shqyrtimit paraprak të rekursit nga Kolegji Civil, në dhomë këshillimi, në mungesë të palëve dhe, po ashtu, në referim të rrethanave të çështjes, rezultojnë se kërkesit kanë pasur në dispozicion mjetin procedural të rekursit në Gjykatën e Lartë, të cilin e kanë ushtruar pa asnjë pengesë, duke parashtruar pretendimet e tyre në lidhje me mosrespektimin e elementeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në proceset gjyqësore të zhvilluara në shkallët më të ulëta të gjyqimit, për të cilat kanë marrë një përgjigje të arsyetuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1237.

26. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkesve për cenimin e të drejtës së ankimit efektiv, të së drejtës për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar dhe standardit të arsytimit, gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, janë të pabazuara.

C. Mbi pretendimet e tjera

27. Kërkesit kanë pretenduar, gjithashtu, cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtruar argumente, si: shoqëria "Dinamo" është legjitimuar pa të drejtë me cilësinë e palës paditëse në procesin civil; interpretimin e gabuar të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993; mungesën e hetimit gjyqësor të plotë; mosmarrjen në konsideratë të provave të administruara; veprimin në kundërshtim me dispozitat ligjore të kohës së shpronësimit, konkretisht me ligjin nr. 61/1945.

28. Gjykata Kushtetuese ka pranuar, në mënyrë të vazhdueshme, se ajo ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja "f" e Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 16, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se për sa kohë kërkesit nuk evidentuan ndonjë standard konkret të së drejtës për një proces të rregullt ligjor që u është cenuar nga gjykatat, si rezultat i legjitimitetit të shoqërisë "Dinamo" sh.a. si palë paditëse në procesin civil, pretendimi në fjalë nuk është ngritur në nivel kushtetues. Për sa u përket pretendimeve mbi interpretimin e gabuar të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993; mungesën e hetimit gjyqësor të plotë; mosmarrjen në konsideratë të provave të administruara; veprimin në kundërshtim me dispozitat ligjore të kohës së shpronësimit, konkretisht me ligjin nr. 61/1945, Gjykata arrin në përfundimin se duke qenë çështje të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese, vlerësimi i tyre i takon juridiksionit të gjykatave të zakonshme, të cilat u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar këtyre çështjeve. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe, aq më tepër, të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkesve është i pabazuar.

Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj.

Anëtar kundër: Bashkim Dedja¹(kryetar)

MENDIM PAKICE

1. Mendoj se vendimi nr. 00-2012-1237, datë 17.5.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit) nuk është në pajtim me nenin 42 të Kushtetutës, për sa vijon:

2. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat, duke anuluar dhe vendimin nr. 80, datë 5.11.1999 të KKKP-së Tiranë, i cili disponon për njohjen dhe kthimin pronarëve/kërkuesve të sipërfaqes 600 m² truall, që gjendet brenda territorit të ish-Uzinës Dajti (kur ndërmarrjet të privatizoheshin), janë shprehur jashtë objektit të padisë, në kundërshtim me nenet 6, 10, 16 dhe 28 të KPC-së (*prg.10.3. i vendimit*).

3. Pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit, janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në gjykimet kushtetuese të kësaj natyre, kur janë konstatuar raste të tejkalimit nga ana e gjykatave të kërkesave të parashtruara në një padi, ato janë konsideruar nga Gjykata Kushtetuese si elemente thelbësore që cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (*vendimet nr. 20, datë 2.7.2003 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, i cili parashikohet në nenin 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas këtyre dispozitave, “*gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet*” (neni 6 i KPC), dhe “*gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj...*” (neni 28 i KPC-së). Në çdo rast, është pala që tregon objektin e gjykimit, kështu që gjykata nuk mund të dalë jashtë objektit të padisë.

5. Në rastin konkret, rezulton se shoqëria “Dinamo” sh.a. ka paraqitur kërkesëpadi për anulimin e vendimeve nr. 145, datë 30.6.1995; nr. 80, datë 5.11.1999 dhe nr. 314, datë 16.9.2000 të KKKP-së Tiranë, dhe konstatimin nul të veprimeve juridike të kryera mbi bazën e tyre dhe regjistrimeve hipotekore si absolutisht të pavlefshme dhe në kundërshtim me ligjin. Shkaku i paraqitjes së kërkesëpadiisë nga ana e shoqërisë “Dinamo” sh.a. ishte mbivendosja e pronës së kthyer pronarëve me atë të kthyer shoqërisë. Në këtë kuptim, objekti i padisë, i përcaktuar nga pretendimet e paraqitura nga shoqëria Dinamo, përcakton kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykatat e zakonshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke anuluar tri vendimet e KKKP-së, ka përfshirë në dispozitiv edhe truallin e lirë me sipërfaqe prej 600 m², brenda ish-uzinës, që nuk ka qenë objekt shqyrtimi gjyqësor, i cili me vendim të KKKP-së i njihej dhe i kthehej pronarit, kur ndërmarrjet të privatizoheshin. Edhe vendimi i gjykatës së apelit ka ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi si kjo gjykatë, duke e lënë në fuqi vendimin e anulimit të vendimeve të KKKP-ve.

¹ Kryetari Bashkim Dedja ka votuar për pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.



6. Në logjikën e përcaktimit të standardit të disponibilitetit, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit kur gjykatat janë shprehur *përtej* asaj që u kërkohet, palëve u cenohet një e drejtë kushtetuese, mendoj se shumica duhet të kishte pranuar kërkesën.

7. Në vijim të kësaj logjike, kërkesa duhej pranuar edhe për shkak të mosarsyetimit të vendimit nr. 00-2012-1237, datë 17.5.2012, nga Kolegji Civil, pasi duke u pretenduar parimi i disponibilitetit, çështja ka qenë brenda nenit 472/2 të KPC-së, sipas të cilit rekursi mund të bëhet edhe për shkelje të rënda të normave procedurale, të listuara në nenin 467 të KPC-së, njëra nga të cilat është dhe disponibiliteti. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të kishte dhënë një “minimum arsyeje” për mospranimin e këtij pretendimi.

8. Për rrjedhojë, vendimi nr. 00-2012-1237, datë 17.5.2012 i dhomës së këshillimit të Kolegjit Civil, ka cenuar të drejtën e kërkuesve për proces të rregullt ligjor, prandaj dhe kërkesa e tyre duhej të ishte pranuar pjesërisht vetëm për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

Anëtar: Bashkim Dedja (kryetar)

VENDIM

Nr. 7, datë 10.2.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Gani Dizdari	anëtar	i	“	“
Fatos Lulo	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 22.10.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 33/6 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shyqyri Toska, përfaqësuar nga av. Baftjar Rusi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Komuniteti Mysliman Shqiptar, përfaqësuar nga av. Selfo Dosti, me prokurë të posaçme.

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në mungesë.

Asllan Hida, përfaqësuar nga av. Selfo Dosti, me prokurë të posaçme.

Ali Rexha, përfaqësuar nga av. Selfo Dosti, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 424, datë 6.10.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f, 134, pika 1/g, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pikat 1 dhe 3, geramat “b” dhe “c”, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në vitin 1992, kërkuesi ka blerë nga Komiteti Ekzekutiv Pluralist i Rajonit nr. 3, Tiranë, një truall me sipërfaqe 730 m², të cilin e ka regjistruar në hipotekë me nr. 1856, datë 30.5.1992.

2. Në vitin 1993, ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë mbi truallin me sipërfaqe 730 m², kërkesëpadi e cila është pranuar me vendimin nr. 4689, datë 3.12.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke marrë formë të prerë në datën 16.12.1993. Prona është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 3560, datë 23.12.1993.

3. Në vitin 1995, Bashkia e Tiranës i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Tiranë me kërkesëpadi për çregjistrimin hipotekor të sipërfaqes objekt i kontratës së shitblerjes. Gjykata, me vendimin nr. 2688, datë 11.5.1995, ka vendosur deklarinimin e pavlefshëm të kontratës dhe, njëkohësisht, udhëzimin e zyrës së hipotekës të çregjistrojë këtë pronë.

4. Në vitin 1996, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt: *“Pushim i cenimit të pronësisë”*, që është rrëzuar me vendimin nr. 9214, datë 14.11.1996, me arsyetimin se *“paditësi nuk legjitimohet të ngrejë padinë në fjalë pasi ai nuk gëzon cilësitë e të qenit pronar dhe as është zhveshur nga posedimi i pronës”*. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Në vitin 2000, Komuniteti Mysliman i është drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) me kërkesë për njohjen dhe kthimin e pronësisë mbi sipërfaqen prej 730 m², shtetëzuar në vitin 1967. KKKP-ja, me vendimin nr. 197, datë 29.5.2000, ka vendosur t'i njohë pronësinë mbi një sipërfaqe toke prej 150 pashë, e ndodhur përballë Medresesë në Tiranë, pronë e cila është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 187, datë 30.6.2000.

6. Vendimi i KKKP-së, midis të tjerash, përcakton se: *“2.1 Dokumentacioni është i plotë dhe konform kërkesave të ligjit. 2.2 Në vitin 1992 ky truall në bazë të kontratës së shitblerjes midis Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Rajonit nr. 3 dhe Shyqyri Toskës ka qenë i regjistruar në hipotekë me nr. 1856, datë 30.05.1992, në favor të këtij të fundit. Me vendimin nr. 2688, datë 11.5.1995 të Gjykatës së Rrethit Tiranë është vendosur deklarinimi i pavlefshëm i kontratës dhe njëkohësisht udhëzimi i zyrës së Hipotekës të çregjistrojë këtë pronë. 2.3 Në vitin 1996, KKKP-ja, mbi kërkesën e Shyqyri Toskës për njohjen pronar mbi 730 m², ka vendosur të mos e njohë ish-pronar atë. 2.4 Në hartën e vitit 1993 trualli prej 150 pashë ka një sipërfaqe prej 486 m² (95+200+191).”*

7. Kërkuesi, duke pretenduar se vendimi i KKKP-së ka mbivendosur pronën e tij me atë që i është njohur Komunitetit Mysliman, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt: *“Anulimin e vendimit të KKKP-së nr. 197, datë 29.5.2000”*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4120, datë 13.10.2003, ka vendosur pranimin e padisë dhe anulimin e vendimit të KKKP-së.

8. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 1484, datë 17.12.2004, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se *“procesi nuk mund të vazhdojë në gjendjen që janë kërkimet e parashtruara në objektin e padisë”*.

9. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 315, datë 2.3.2006, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

10. Në përfundim të procesit të rigjykimit të çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 223, datë 23.2.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 737, datë 30.5.2008, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Komunitetit Mysliman (palë e paditur) dhe ndërhyrësit kryesorë A.H. dhe A.R.

12. Komuniteti Mysliman dhe ndërhyrësit kryesorë A.H. dhe A.R. i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e cila, me vendimin nr. 1, datë 25.1.2010, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

13. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 424, datë 6.10.2011, ka vendosur ndryshimin e vendimeve nr. 223, datë 23.2.2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 4120, datë 13.10.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë së paditësit Shyqyri Toska.

II

14. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 18.2.2013 me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:



14.1 Është cenuar *parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në kundërshtim me ligjin procedural, ka ndryshuar rrethanat e çështjes dhe u ka dhënë kuptim të kundërt provave të marra në dy shkallët e para të gjykimit, duke i rivlerësuar ato në mënyrë të njëanshme. Ekspertët topografikë e zgjidhën përfundimisht konfliktin midis palëve ndërgjyqëse, pasi provuan se prona e paditësit nuk mbivendoset me atë të Komunitetit Mysliman, e cila është 150 m larg në veri-perëndim të pronës objekt gjykimi. Ndonëse sipas tyre, akti i pronësisë së palës së paditur nuk përputhet sipas aktit të ekspertimit as në kufij, as në shenja konvencionale të hartës dhe as në sipërfaqe, Gjykata e Lartë, në kundërshtim me nenin 229 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar kompetencat e ekspertit topografik duke vlerësuar dhe zgjidhur çështjen ndryshe nga përfundimet e dy akteve të ekspertimit tekniko-topografik, të kryer gjatë hetimit gjyqësor të çështjes.

14.2 Po ashtu, është cenuar *parimi i paanësisë, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim*, pasi gjatë procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë ka analizuar në mënyrë të njëanshme vetëm shkaqet dhe provat e paraqitura nga palët kundërshtare dhe ka anashkuar aktet dhe vendimet e formës së prerë të palës paditëse, duke deformuar përmbajtjen e tyre.

14.3 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike dhe i gjësë së gjykuar*, pasi Gjykata e Lartë:

14.3.1 Nuk ka marrë në konsideratë shkresën nr. 769 dhe 769/1, datë 25.11.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, që konfirmon faktin se “prona në fjalë nuk është shpronësuar, se ka qenë dhe është në posedim të pandërprerë të familjes Toska”. Marrja e vendimit nr. 197/2000 nga KKKP-ja cenon pritshmëritë e ligjshme të kërkuesit dhe besimin e tij tek drejtësia.

14.3.2 Ka vënë në diskutim vlerën e vendimit gjyqësor civil të formës së prerë nr. 4689, datë 3.12.1993, i cili nuk kanë qenë objekt i ndonjë procesi rishikimi.

14.4 Është cenuar *parimi i paanshmërisë në gjykim*, pasi:

14.4.1 Në përbërje të Kolegjit Civil që ka zgjidhur çështjen në themel, duke ndryshuar dy vendimet gjyqësore, kanë qenë edhe tri nga gjyqtarët që kanë vendosur në dhomë këshillimi kalimin e rekursit për shqyrtim në seancë plenare.

14.4.2 Në vendimin përfundimtar, emri i gjyqtarit M.B., i cili ka qenë në përbërje të Kolegjit Civil që ka shqyrtuar çështjen, nuk përputhet me emrin e gjyqtarit F.L., që ka nënshkruar vendimin.

15. **Subjektet e interesuara, Komuniteti Mysliman, Ali Rexha dhe Asllan Hida** kanë prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

15.1 Komuniteti Mysliman ka pasur në pronësi truallin prej 730 m² nga data 20.3.1919 (regjistruar në ZRPP nr. 233) deri në vitin 1967, kur u shtetëzua pa shpërblim me dekretin e PKP nr. 4263, datë 11.4.1967. Pronësia mbi këtë sipërfaqe iu rinjoh në vitin 2000 nga KKKP-ja, duke i kthyer fizikisht 486 m² truall i lirë, të cilin e regjistroi në ZRPP, nr. 187, datë 30.6.2000. Pjesa tjetër e truallit i është kthyer me vendimin nr. 1802, datë 1.4.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

15.2 Pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë ka cenuar *parimin e gjykatës së caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi kërkuesi i referohet një paragrafi të veçuar (nr. 19) të vendimit të Kolegjit Civil, ndërkohë që injoron kontekstin e arsytimit ligjor të vendimit. Për më tepër, Kolegji Civil, duke mos i dhënë vlerë si titull pronësie vendimit gjyqësor të vërtetimit të faktit të pronësisë, ka arritur në përfundimin se ai nuk kishte legjitimitet për të vlerësuar bazueshmërinë në prova e në ligj të vendimit të Komisionit të Pronave.

15.3 Trualli mbi të cilin kërkuesi pretendon të drejtën e pronësisë përbën një parcelë të veçantë të ndryshme nga trualli prej 858 m², të trashëguar nga babai i tij, ku ka ndërtuar shtëpinë, dhe nga trualli prej 633 m² në pronësi të vëllait të tij. Ky fakt provohet nga akti i ekspertimit, datë 3.11.2004, i hartuar nga grupi i ekspertëve të caktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, sipas të cilit pronat nuk mbivendosen pasi ndodhen 150 m larg njëra-tjetrës. Nuk rezulton që ai të ketë përdorur ndonjë mjet juridik të përshtatshëm për të siguruar një titull pronësie, përmes një gjykimi me palë kundërshtare.

15.4 Edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë dhe barazisë para ligjit është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar prova, por ka interpretuar ligjin dhe ka respektuar normat procedurale për trajtimin e palëve në mënyrë të barabartë dhe të paanshme.

15.5 Gjithashtu, i pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi nr. 4689, datë 3.12.1993 është një vendim gjyqësor për pranimin e një kërkesë për vërtetimin e

faktit juridik të pronësisë, i dhënë pas një gjykimi pa palë kundërshtare. Në këtë kuptim, një vendim i tillë nuk merr fuqinë *e res judicata* dhe, për rrjedhojë, nuk është i detyrueshëm për gjykatën, institucionet shtetërore dhe palët e treta. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, një vendim i tillë nuk mund të jetë as objekt rishikimi bazuar në nenin 494 e vijues të KPC-së. Kodi Civil i mëparshëm dhe Kodi Civil aktual e ndalojnë regjistrimin si titull pronësie të vendimeve gjyqësore të vërtetimit të faktit të pronësisë dhe, po ashtu, nuk i konsiderojnë si vendime të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

16. Gjykata, paraprakisht, thekson se ajo i vlerëson pretendimet e kërkuesve në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor, dhe, konkretisht, në aspektin e detyrimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për respektimin e këtyre standardeve.

A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

17. Në kërkesën e paraqitur përpara Gjykatës, kërkuesi i referohet rregullimit kushtetues të parashikuar në nenin 42 dhe 131, shkronja “f” të Kushtetutës, të cilat lidhen me respektimin e standardit “*të gjykatës së caktuar me ligj*”, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kërkuesi pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 424, datë 6.10.2011, ka tejkaluar kompetencat e parashikuara nga ligji procedural civil, pasi nëpërmjet rivlerësimit të provave të marra gjatë gjykimit në shkallën e parë dhe në gjykatën e apelit, ka ndryshuar rrethanat e çështjes. Në këtë proces gjyqësor, Kolegji Civil ka marrë, gjithashtu, edhe kompetencat e ekspertit topograf kur ka vlerësuar vendndodhjen e pronës objekt gjykimi.

18. Gjykata rithekson se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjyqarit të faktit, por duhet të kthejë çështjen për rishqyrtim me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata konstaton se gjatë shqyrtimit të çështjes civile në dy shkallët e para të gjykimit janë kryer dy ekspertime teknike, të cilat i kanë dhënë përgjigje pyetjeve të parashtruara nga gjykata dhe palët ndërgjyqëse. Akt ekspertimi i vitit 2003, i cili është kryer nga një ekspert topograf, me kërkesë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka përcaktuar se: “*Pozicionimi i pronës është i vështirë për shkak të pasaktësive që ka në lidhje me kufitarët në regjistrin hipotekor nr. 233, datë 20.3.1919. Trualli me sipërfaqe 730m², objekt konflikti, nuk ka të bëjë me sipërfaqen prej 1521 m² që paditësi ka trashëguar nga babai, të hipotekuar në vitin 1936; banesa e Shyqyri Toskës gjendet 40-50 m larg sipërfaqes objekt konflikti; Vendndodhja e pronës së Komunitetit Mysliman nuk përputhet me vendndodhjen e pronës të kthyer me vendim të KKKP-së, pasi ato kanë sipërfaqe dhe dimensione të ndryshme*”. Kurse nga përmbajtja e aktit të ekspertimit të



datës 3.11.2004, i përgatitur nga dy ekspertë topografë mbi kërkesën e Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se: *“Origjina e pronës së Komunitetit Mysliman, sipas regjistrit hipotekor të vitit 1919, është varrezë me sipërfaqe 150 (pa njësi të përmendur), shenja konvencionale e së cilës nuk figuron në sipërfaqen objekt gjykimi sipas regjistrit hipotekor të viti 1937, por gjendet në distancë 150 m veri-perëndim; Ka mbivendosje midis sipërfaqes që figuron në vendimin gjyqësor nr. 4689/1993 me objekt vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së Shyqyri Toskës dhe sipërfaqes mbi të cilën disponon vendimi nr. 197/2000 i KKKP-së për Komunitetin Mysliman, bazuar në regjistrin hipotekor të vitit 1919.”*

20. Gjykatat e të dy shkallëve të para, duke u bazuar, midis të tjerash, edhe në konkluzionet e akteve të mësipërme të ekspertimit teknik-topografik, respektivisht kanë vendosur pranimin e padisë së Shyqyri Toskës dhe anulimin e vendimit të KKKP-së. Gjykata e Apelit Tiranë, duke e vlerësuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si në përputhje me ligjin, ka vendosur lënien e tij në fuqi, duke arsyetuar se: *“Komunitetit Mysliman nuk i është shtetëzuar, shpronësuar ose konfiskuar prona prej 150 pashë, prandaj vendimi nr. 197/2000 i KKK-së është marrë në kundërshtim me ligjin...Edhe në rast se prezumohet ndonjë nga veprimet e mësipërme, Komunitetit Mysliman i është kthyer 730 m², ndërkohë që prona e origjinës është 487 m²... Pozicionimi i pronës së kthyer është i gabuar, pasi nuk përputhet përshkrimi i vendndodhjes në vendim me atë në terren, siç u provua nga ana e ekspertëve topografë...Një tjetër shkelje e ligjit nga KKKP-ja është edhe fakti që është shprehur për një pronë e cila ka qenë e zënë nga persona të tjerë, duke mos respektuar detyrimin ligjor për verifikimin në vend të pronësisë dhe përgatitjen e hartës përkatëse në përputhje me vendimin nr. 301, datë 14.6.1993...Pretendimi për moslegjitimitimin e paditësit është i pabazuar, pasi paditësi ka vërtetuar faktin e qenies pronar mbi këtë sipërfaqe, që e ka regjistruar në ZRPP..Kodi i ri Civil e ka konsideruar regjistrimin e vërtetimeve të faktit juridik pa palë kundërshtare, të paligjshme., kurse sipas Kodit Civil të vjetër nuk ka pasur pengesë ligjore... Po ashtu, KKKP-ja nuk ka respektuar udhëzimin nr. 3/1993, që parashikon rregullat kur trualli objekt kthimi ose kompensimi ka qenë i zënë si në rastin konkret.”*

21. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta janë marrë duke çmuar në mënyrë të gabuar provat dhe duke zbatuar keq ligjin dhe, për këtë arsye, ka vendosur ndryshimin e tyre dhe rrëzimin e padisë. Kolegji Civil arrin në përfundimin e mësipërm, bazuar në argumentet si vijon: *“...edhe pse gjykatat e kanë legjitimuar paditësin në ngritjen e kësaj padie, nisur nga provat e ndodhura në dosjen gjyqësore, paditësi nuk ka arritur të provojë origjinën e pronës (truallit objekt gjykimi) dhe as mënyrën e fitimit të pronësisë (§13)... Edhe pse përmes vendimit gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë paditësi ka regjistruar truallin, ai vendim është pa palë kundërshtare dhe nuk mund të vlejë për njohjen dhe kthimin e pronës (§ 14) dhe... nuk mund të ketë fuqinë e aktit për t'u përdorur për kundërshtimin e pronësisë të një pale tjetër, të pajisur me dokumente pronësie apo akte që provojnë se kanë pasur një pronë (vendimi nr. 12, datë 15.7.1918 i komisionit të Vakëfit Tiranë dhe shkresa shoqëruese nr. 85, drejtuar Bashkisë për regjistrimin e varrezave), të cilat janë hedhur poshtë nga gjykatat (§§ 18-17)... edhe pronësia e dy ndërhyrësve dytësorë është fituar me kontratat e shitjes, është pronësi e fituar në një nga mënyrat e parashikuara nga Kodi Civil (neni 164) (§ 20).”*

22. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret, Gjykata e Lartë nuk ka marrë prova të tjera, por e ka shqyrtuar dhe analizuar çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë në ligj të vendimeve të ankimuar, të cilat, në përfundim të shqyrtimit, janë çmuar si të marra në shkelje të ligjit. Kolegji Civil, duke arsyetuar se gjykatat i kanë çmuar gabim provat dhe kanë zbatuar keq ligjin material, ka ushtruar kompetenca që atij i përcaktohen ekskluzivisht nga ligji.

23. Nisur nga qëndrimi i konsoliduar i jurisprudencës kushtetuese se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar.

B. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanësisë, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

24. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se gjatë procesit gjyqësor civil, Gjykata e Lartë ka analizuar në mënyrë të njëanshme vetëm shkaqet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur dhe, duke cenuar parimin e kontradiktoritetit, ka anashkaluar aktet dhe vendimet e formës së prerë të palës paditëse, madje ka deformuar përmbajtjen e tyre. Sipas kërkuetit, Kolegji Civil analizon në mënyrë të njëanshme vendimin nr. 2688, datë 11.5.1995, ku me pëlqimin e paditësit është prishur kontrata e shitjes së vitit 1992 dhe fshirë nga regjistri hipotekor, ndërkohë që, qëllimisht, injoron vendimin nr. 4689, datë 3.12.1993, dhe regjistrimin e tij në hipotekë. Po ashtu, Kolegji Civil i shtrin efektet e dispozitave të Kodit Civil të vitit 1994 edhe në marrëdhënie juridike që kishin lindur përpara hyrjes së tij në fuqi.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka ritheksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se argumentet e parashtruara nga kërkuesi kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë. Po ashtu, Gjykata çmon se mungojnë argumentet kushtetuese për të ngritur në nivel kushtetues pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë “*dyshimin e bazuar për cenimin e elementit objektiv dhe subjektiv*”, apo të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit “*mundësia e arsyeshme për palën për të paraqitur pretendimet sipas kushteve të cilat nuk e vendosin në dizavantazh ndaj kundërshtarit; mundësia që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës*”.

27. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuetit janë haptazi të pabazuara.

C. Në lidhje me pretendimin për cenimin e gjësë së gjykuar

28. Sipas kërkuetit, vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me nenin 451, pika “a”, të KPC-së, pasi ka vënë në diskutim vlerën e vendimit gjyqësor civil të formës së prerë nr. 4689, datë 3.12.1993 dhe të akteve administrative që kanë lidhje me çështjen.

29. Në jurisprudencën e saj Gjykata, në lidhje me parimin *res judicata*, ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera (*shih vendimin nr. 15, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka çmuar se parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e të drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t’i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Nga përmbajtja e vendimit të formës së prerë nr. 4689, datë 3.12.1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë mbi truallin objekt kundërshtimi, rezulton se procedura gjyqësore është bazuar në nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile të vitit 1981. Procesi është zhvilluar pa palë kundërshtare dhe vlerësimi i gjykatës është bazuar në dokumentet e mëposhtme: (i) një certifikatë të zyrës së ndihmës juridike Tiranë, sipas të cilës rezulton se: “*sipas regjistrimit nr. 335/12 datë 22.7.1935,*



në emër të babait të kërkuarit figuron një truall me sipërfaqe 33 m² i gjerë dhe 53 m² i gjatë, gjithsej 174 m². Kjo pjesë trualli është toka që e zë sot banesa e kërkuarit dhe një oborr afër shtëpisë, që sipas dëshmitarëve, babai i kërkuarit e ka përdorur si tokë bujqësore për të plotësuar nevojat e familjes deri kur u mor nga shteti dhe u bë lulishte”; (ii) vërtetim pronësi hipoteke e vitit 1992; (iii) kontrata e blerjes datë 30.5.1992 me rajonin nr. 3 Tiranë.” Vendimi nuk është kundërshtuar nga ndonjë person fizik ose juridik dhe ka marrë formë të prerë në datën 22.12.1993.

31. Gjykata e Lartë, në vendimin objekt kundërshtimi, në lidhje me vendimin e formës së prerë nr. 4689, datë 3.12.1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë mbi truallin, arsyeton se: *“Edhe pse përmes vendimit gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë paditësi ka regjistruar truallin, ai vendim është pa palë kundërshtare dhe nuk mund të vlejë për njohjen dhe kthimin e pronës (§ 14) dhe... nuk mund të ketë fuqinë e aktit për t’u përdorur për kundërshtimin e pronësisë të një pale tjetër, të pajisur me dokumente pronësie apo akte që provojnë se kanë pasur një pronë (vendimi nr. 12, datë 15.07.1918, i komisionit të Vakëfit Tiranë dhe shkresa shoqëruese nr. 85 drejtuar Bashkisë për regjistrimin e varrezave), të cilat janë hedhur poshtë nga gjykatat (§§ 18-17)... edhe pronësia e dy ndërhyrësve dytësorë është fituar me kontratat e shitjes, është pronësi e fituar në një nga mënyrat e parashikuara nga Kodi Civil (neni 164) (§ 20).”*

32. Në përfundim, Gjykata vlerëson, nisur nga kuptimi i parimit të gjësë së gjykuar dhe bazuar në natyrën e vendimit nr. 4689, datë 3.12.1993, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, se pretendimi i kërkuarit është i pabazuar.

D. Mbi pretendimin e cenimit të parimit të paanësisë në gjykim

33. Kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, edhe cenimin e parimit të paanësisë në gjykim, duke parashtruar si argumente, së pari faktin se në përbërje të Kolegjit Civil që ka zgjidhur çështjen në themel, duke ndryshuar dy vendimet gjyqësore, kanë qenë edhe tre nga gjyqtarët që kanë vendosur në dhomë këshillimi kalimin e rekursit për shqyrtim në seancë plenare dhe, së dyti, faktin se në vendimin përfundimtar, emri i gjyqtari M.B., i cili ka qenë në përbërje të Kolegjit Civil që ka shqyrtuar çështjen, nuk përputhet me emrin e gjyqtarit F.L., që ka nënshkruar vendimin.

34. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ai zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëmrisht i bazuar (*shih vendimin nr. 41, datë 10.10.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Nisur nga argumentet e kërkuarit, Gjykata çmon të sjellë në vëmendje karakteristikat e procesit që zhvillohet në Kolegjin e Gjykatës së Lartë, i cili është organi që analizon dhe vlerëson, në dhomë këshillimi, nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t’u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyesimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraprak përzgjedhës të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, prima facie i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund t’ia deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit (*shih vendimin nr. 18, datë 18.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit, për verifikimin nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t’iu drejtuar gjykatës apo të asaj për një gjykim publik, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimin nr. 45, datë 23.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Për sa i përket seancës gjyqësore, ajo përfaqëson një vijim logjik të procedurës gjyqësore në rast se Kolegji Civil, në dhomë këshillimi, ka arritur në përfundimin se rekursi përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së. Në këtë rast, Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, është e detyruar të përqendrojë kontrollin e saj vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Nëse pranimi ose mospranimi i rekursit vendoset pa pjesëmarrjen e palëve, në seancë gjyqësore, janë avokatët e palëve të cilët paraqesin mbrojtjen e tyre, pa pasur të drejtën e replikës (neni 489 i KPC).

37. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson paraprakisht se çështja objekt gjykimi nuk ka asnjë karakteristikë të përbashkët me vendimmarrjet e kësaj Gjykate, të cilave u është referuar kërkuesi në kërkesë apo gjatë seancës gjyqësore, raste në të cilat cenimi i parimit të paanshmërisë është konstatuar për faktin se gjyqtarët në ato çështje e kanë shqyrtuar, në themel, çështjen në të dy kolegjet e Gjykatës së Lartë, apo në shkallë të ndryshme. Në këtë kuptim, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret paanshmëria objektive dhe subjektive e tre gjyqtarëve, të cilët kanë qenë njëkohësisht të pranishëm si në dhomë këshillimi ashtu dhe në seancë gjyqësore, nuk lë shkas për dyshime dhe, për rrjedhojë, frika e kërkuetit mbi njëanshmërinë e tyre gjatë procesit gjyqësor është e paarsyeshme dhe dyshimi i tij nuk mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar për të vënë në diskutim vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga këndvështrimi i respektimit të standardeve kushtetuese.

38. Për sa i përket argumentit të dytë të kërkuetit që lidhet me nënshkrimin e vendimit nga një gjyqtar i ndryshëm nga ai që është në përbërje të Kolegjit Civil, Gjykata vlerëson se ai nuk është ngritur në nivel kushtetues.

39. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi janë të pabazuara dhe se kërkesa nuk përmban asnjë shkak të tillë që mund të lidhet me cenimin e ndonjë prej elementeve të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 20 lekë

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007